

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zgjidhen tre anëtarët e rinj gjyqtarë të KLGJ-së
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/25/zgjidhen-tre-anetaret-e-rinj-gjyqtare-te-klgj-se/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 18:13:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 18:07:24 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	34de886a67bd3247d3a001f3d2dd1456a86c41d35551235b60e81b2dce65f3b5
TEKSTI	e189a4f410a2486f57bcb4bf34380099fbd0168bdef90d93d84382475ff18454
PAMJA	c192db4530cf81c1e979877278f4fb7fda3ce4ab6fc225bda5f2f111d01ca20a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	683fc38258e459e25b23b988d076b3c11f78abc0bb6ccf3874bf4a4ddb15a8f9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b795f32e8dccad3401c122ecb35fb566e35fee7f00b27116f873c51e2a9a0ff8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/683fc38258e459e25b23b988d076b3c11f78abc0bb6ccf3874bf4a4ddb15a8f9

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kryefaqja Lajme

Zgjidhen tre anëtarët e rinj gjyqtarë të KLGJ-së

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve përzgjedhi mes shtatë kandidatëve për tre pozicione në Këshillin e Lartë Gjyqësor, gjyqtarët Fatri Silamaj, Brunilda Kadi dhe Sandër Simoni, për nga një mandat pesë vjeçar.



nga Edmond Hoxhaj — 1 minute më parë në Lajme Koha e leximit: 2 min lexim

AA 0



Gjyqtari Sander Simoni

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve zgjidhi të premtën më 25 shtator tre anëtarët e rinj magistratë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, KLGJ, gjyqtarin Sandër Simoni, gjyqtarin Fatri Islamaj dhe gjyqtaren Brunilda Kadi.

Nga Gjykata e Lartë kandiduan për një vend në KLGJ, gjyqtarët Arbena Ahemti dhe Sandër Simoni. Ata dolën barazim duke siguruar nga 179 vota secili. Sipas rregullores, u vijua me përzgjedhjen me short dhe pas shortit me gogla, fitues rezultoi gjyqtari Sandër Simoni. Gjyqtarja e Apelit të Posaçëm, Igerta Hysi mori mbështetjen e 171 kolegëve, ndërsa kandidati Fatri Islamaj u përzgjedh fitues me 190 vota.

Gjyqtari Sandër Simoni u ushtroni funksionin në Gjykatën e Lartë prej 19 marsit të vitit 2021. Më parë ai ka qenë gjyqtar dhe kryetar i ish-Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Simoni ka shërbyer edhe si anëtar dhe kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, KED dhe është pedagog i jashtëm në Shkollën e Magistraturës për Procedurën Penale.

Gjyqtari i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fatri Islamaj, ka mbajtur gjatë periudhës 2012-2016 funksionin e kryetarit të Gjykatës së Rreghit Gjyqësor Tiranë. Edhe ai ka qenë anëtar i KED, si dhe është pedagog i jashtëm në Shkollën e Magistraturës.

Nga tre gjyqtaret e Shkallës së Parë që garuan, Matilda LLangozi, Manjolla Xhaxho dhe Brunilda Kadi, u zgjedh fituese kjo e fundit. Gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Brunilda Kadi ka qenë më parë anëtare e KLGJ-së, për periudhën 2018-2021. Ajo ka shërbyer si gjyqtare edhe në Fier e Elbasan.

Tre të zgjedhurit për nga një mandat 5-vjeçar, do të zëvendësojnë kolegët e tyre, anëtarët gjyqtarë Klodian Kurushi, Ridvan Hado dhe Irena Plaku, të cilëve ju mbaron mandate më 12 dhjetor. Këshilli i Lartë Gjyqësor, përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve vijnë nga radhët e gjyqtarëve, ndërsa pesë të tjerët zgjidhen nga Kuvendi prej radhëve të juristëve të shquar.

Zgjidhen tre anëtarët e rinj gjyqtarë të KLGJ-së

20:07 | 25/09/2026

Organizatrat e medias denoncojnë sjelljen e policisë ndaj gazetares së Citizens.al

15:12 | 25/09/2026

Mjedisorët dërgojnë në Kushtetuese vendimin që zhveshi nga mbrojtja Pishë Poro-Nartën

13:37 | 25/09/2026

Nga aleatë të SHBA-së në të pandehur: Pse Uashingtoni e mbështeti Gjykatën Speciale për Kosovën

11:34 | 25/09/2026

Futja e Ballkanit në Shengen: një zgjidhje me përfitime për Evropën

09:59 | 25/09/2026

Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit

08:08 | 25/09/2026

Reporter.al

Opinion
Reportazhe
Analiza
Investigime
Lajme
Blog
Rajoni

Rreth nesh
Stafi
Kontakttoni
Ankesa dhe Korrigjime
Politika e privatësisë dhe
rregulla të tjera
Letra për redaktorin

Follow Us



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN

Dev by [Sfida.PRO](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.